

TELEGRAM PREJ VARREZËS

poezi*

*Tashmë njoh të gjitha daljet prej Romës,
e megjithatë nuk e di sesi hyhet*

*marrë prej librave “Sfinksi”, ”Mbretëria e gjërave të ndaluara”, ”Të duartokasësh Kaligolën”, ”Telegram prej varrezës”.

Gjithë trupi im është dhimbja
e një erupsioni të pamundshëm.

I paaftë jam ta vjell
atë të squllët e të errët meduzë
brenda lëvres sime,
i pazotë jam ta degdis atë masë të gurëzuar
që mbush kafkën.

Truri më kot përpiqet të godasë membranën,
është gangrena që bllokun shtegun e shpëtimit.
Mendja pa dobi përpiqet të bëjë hapin e gaforres,
është kanceri që bllokun derën e tualetit.

E dashur, nuk jemi njohur kurrë më parë,
ishin larvat tona
hibride resh dhe mjegullash.

Është ora të ikim Sokrat,
ne të kthejmë patkonjtë,
të tjerë të bëjnë sikur jetojnë,
por askujt s'i është e qartë
kush shkon drejt më së mirës.
Mbërriti shpejt perëndimi i Quazimodos
e shpejt do t'u hiqemi sysh kandrrave,
por në kërcimin e fundit në terrloti i penduar
që s'mundëm ta përceptojmë
muzgun e Dahaut,
e të shumë gjërave të tjera kurrë të përjetuara,
e plot të tjerash kurrë të përfunduara,
të pendimeve kurrë të ardhura
e të krimeve kurrë të rrëfyera,
dhe dënesën e shurdhër
të një grushti të shtrenjtësh
të mbijetuar nëpër tokë.

Gjendet gjithmonë
dikush që derdh lot
nën trekëmbëshin
e tiranit,
gjendet gjithmonë
kush epshohet.

Midis orgjisë
- xhelati
që ndjen
njëlloj
prej lotit dhe orgazmës.

Dhe unë
që më në fund
shkoj të prehem
në strofullën e mëkatit.

Shkëmbi
tashmë
u gërrye,
por
edhe
dallga
është
e vdekur.

Shpëtomë, o Zot, nga obsesioni i vështrimit
të mbërthyer mbi kutizën postare,
banesë e ngashërimit të mesazheve
të mbështjella me qefin.
Shpëtomë, o Zot, nga dihatja e hapit të telegramit
të postuar nga varreza e largët.

Jam duke ju çuar në litar, por ju mbeteni inertë;
jam duke ju vetëtuar, por ju jeni të verbër;
unë ulërij, ulërij, ulërij, por juve ju mungojnë veshët,
jam duke ju përvëlur dhe zjarri po ju arrin tek sytë
por ju, copa mermeri, vazhdoni të mbikëqyrni meteorët,
të kërkoni armikun në planete të tjerë
e derisa flaka s'u ka plasur retinën
si të luajtur vazhdoni t'i këndonin kiametit tuaj.

Unë thërres Woytila e përgjigjet guru Asahara ,
unë thërres Sebastianos e përgjigjet Zhirinovskij,
unë thërres De Gasperi e përgjigjet Musolini,
unë thërres Nënë Tereza e përgjigjet Barbarella,
unë thërres Budda e përgjigjet Muhameti,
unë bërtas e ulërij, çirrem e angullij,
në sfilatjen titanike
për të deshifruar kodin e gabuar të gjithësisë.

Kam kërkuar Edenin dhe gjeta Skëterrën,
bo! bo! Kam duartrokitur J.F.K.
dhe më është ngërdheshur Neroni,
një strehë për të tjerët kërkova
dhe humba shtëpinë time,
një botë për të gjithë ëndërrova
dhe humba atdheun tim.
Thuamëni, ju lutem, që s'jam i marrë,
që s'duhet të vazhdoj kërkimin kurvë,
nëse jo, ofromëni një copë litar,
nëse jo, ofromëni një qivur.

Panteoni në black-out, shurdhërisht
kremtohet lavdia e skarafaxhove.

E pashë Napolin, pastaj nuk kërkova të vdisja,
shkova të gjerb një kafé sizmike
në lagjet spanjolle.

Nëse unë them zbardh, ti bërtet nxin,
nëse unë them zog, ti menjëherë dhelpër,
nëse unë ëndërroj akullin, ti menjëherë zjarrin,
unë shkruaj Hitler, ti shpejt Stalin,
unë lexoj Duçe, ti shpejt Pertini,
unë i gjelbër, ti e zverdhur,
unë rrugë, ti skutë,
unë gjumë e ti kalvar,
unë Jesù e ti Pilat,
ç'të bësh, ç'të bësh,
bota është kaq e vockël
e s'mund të jetojmë dot veç e veç.

Gratë
i zotëroja
prandaj i përçmoja.

Yo, "The Game",
por edhe në qerpikun tim
gjen gjithmonë një bulë
të hidhur
të dashnoreve
të shpërdoruar.

Nëna ime ndjehej frikshmërisht keq
dhe e mësova prej një udhëtari 6 muaj më pas;
daja qe transferuar në qiell
dhe munda ta di një vit më vonë prej një shoferi;
porta e shtëpisë sime qe thyer,
kush më spiunonte tash është president
dhe munda ta marr vesh dy vjet më pas
prej një gazete të ricikluar.
Atdheu im po shpërbëhej
dhe m'u njoftua prej TV- së të tjerëve,
haluçinacionet e mia ishin ç'helmuar,
të mbeturat të akulluara,
por pasqyra ishte e thyer
dhe shpirtkënaqur s'mund t'i numëroja rrudhat.

Jam i parazgjedhur të hip
mbi qerren e të mundurve.

Është koha e rrafshimit të monumenteve tuaja
dhe i ngritjes së tonave,
të bëjmë të rindrisin prapë gratë tona
e t'i ribëjmë të qajnë tuajat,
e sqimës së bijve tanë-ushtarë
dhe e vënies në gjunjë të tuajve,
e smokingëve tanë të markës
dhe e qivureve tuaja të kalbura.
Dhe s'dihet se për kë Zotat po përgatisin
mermerin e nesërm,
bronxin e ardhshëm,
këshilluar prej Mark Aurelit.

Ke qenë përsëritshmërisht i mprehtë
për të thërrmuar shumë kuaj Troje,
por asnjëherë nuk ke kuptuar
kush ishte Odiseu.

Më vjen keq, Galilè,
kanë kaluar qindra vjet,
e megjithatë asgjë nuk lëviz.

Ditët e derdhura për të vuajtur
janë çmendurisht të papërfillshme,
nuk mjaftojnë për të na xhuxhëzuar,
përtharë,
çtrurëzuar.

Netët e dhëna për t'u dëfryer
janë hiçi i paprekshëm.
Lipset zgjerimi i harkut jetësor
dhe një tjetër shpërndarje
riguar prej qiellit
o e shpërthyer nga rrënjët e magmës.

I prenë duart.
Pastaj
i dhanë një baketë
për të dirigjuar
Verdin.

Vrumbullij,
më urreni;
buzëqesh,
mallkoni si më parë;
mirupafshi im,
përçmimi juaj.

Hesht,

nuk është tjetërqysh.

Duhet të pendohesh, Euklid, për aksiomën

e vijave të drejta që s'takohen kurrë,

ndoshta të është përvjedhur elektromagnetizmi i urrejtjes
që mbush boshin e bën të takohen drejtëzat,

materia mjegulluese

që eksiton ndryshmërite tona,

korrenti elektrik i qenërimit,

fusha magnetike e helmit,

tensioni i lartë i keqdashjes.

Të zgjohesh

në fund

të greminës,

sa

të rënda

eshtrat!